



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 24076 prot.

Shkodër, më 20.11. 2025

**PROJEKTVENDIM
PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS DHE DHËNIEN E MANDATIT TË ANËTARIT TË
KËSHILLIT BASHKIAK**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të radhës , në mbështetje të nenit 49, pika 1 dhe 2, nenit 54, shkronja “j”, nenit 55, pika 3 të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, nenit 164 të Kodit Zgjedhor,shkresës Nr.6842, datë 30.10.2025 si edhe Vendimit Nr.1459 , datë 29.10.2025 të Komisionit Qendor të Zgjedhjeve dhe relacionit nr. 23617 prot., datë 14.11.2025 të Komisionit të Mandateve,

VENDOSI :

1. Plotësimin e vakancës dhe miratimin e dhënies së mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Shkodër Z.Sead Sabah Jusha, si kandidat i listës shumëëmërore të Partisë Socialdemokrate.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretaria e Këshillit Bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

SEKRETARE

Sabina Danaj

KRYETAR

Oltion LULI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 23617 prot.

Shkodër, më 14 . 11 . 2025

Lënda: *Relacion*

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Komisioni i mandateve të këshillit bashkiak Shkodër, sot në datën 14.11.2025, mori në shqyrtim mori në shqyrtim plotësimin e vakancës në këshillin bashkiak Shkodër, me kandidatin nga lista shumëemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialdemokratike z.Sead Jusha.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton:

KQZ me vendimin nr.1459, datë 29.10.2025, referuar shkresës nr.19303 prot., , datë 29.09.2025 të Këshillit Bashkiak Shkodër, për krijimin e vakancës nga këshilltari z. Erkan Hoxha, ka vendosur plotësimin e vakancës me kandidatin nga lista shumëemërore e Partisë Socialdemokrate, Z.Sead Sabah Jusha.

Referuar dokumentacionit që disponojmë, nuk rezultojnë kushte të papajtueshmërisë, sipas ndalimeve të nenit 47, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Për sa sipër komisioni mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak Shkodër”, vlerëson dhe i propozon këshillit bashkiak, marrjen e vendimit përkatës për dhënien e mandatit të këshilltarit z Z.Sead Sabah Jusha.

KOMISIONI

SEKRETAR

Izmira RUSI

KRYETAR

Uarda GJEKAJ

ANËTAR

Gjovalin NDOJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues KAZ Nr.Prot. 6842, Data 30.10.2025

Shkurtimi i lëndës Njoftim për vazhdim procedurave

Për trajtim nga:	☐ N/Kryetar	☐ Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit	☐ Nj.A Ana e Malit
	☐ N/Kryetar	1. Drejtoria e Sportit	☐ Nj.A Bërdicë
	☐ N/Kryetar	2. Drejtoria e Kulturës	☐ Nj.A Dajç
	☐ Kabineti Z.	3. Teatri "Migjeni"	☐ Nj.A Guri i Zi
	☐ Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit	☐ Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	☐ Nj.A Postribë
	1. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	1. Drejtoria Juridike	☐ Nj.A Pult
	2. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit	2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore	☐ Nj.A Rrethina
	3. Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme	3. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse	☐ Nj.A Shalë
	4. Drejtoria e Aseteve dhe Kadastrës Urbane	4. Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit ZIN dhe TIK	☐ Nj.A Shosh
	☐ Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik	☐ Drejtoria e Përgjithshme Shërbimeve Sociale dhe Rinisë	☐ Nj.A Velipojë
	1. Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit	1. Drejtoria e Shërbimeve Sociale	☒ Këshilli Bashkiak
	2. Drejtoria e Turizmit	2. Drejtoria e Ndihmës Ekonomike	☐ Njësia e Menaxhimit të projekteve strategjike
	3. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP	☐ Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar	☐ Policia Bashkiake
	☐ Drejtoria e Arsimit	1. Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor	☐ Emergjencat Civile
		2. Drejtoria e Financës	☐ Njësia e Prokurimit
		☐ Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore	☐ Njësia e Auditit
	☐ Ndërmarrja e Shërbimeve dhe Punëve Publike	☐ Q.Trajtimit të Studentëve	☐ Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.a.
	☐ Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike	☐ Shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç	☐ IMT
	☐ Drejtoria e MZSH	☐ Shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç	☐ Gjendja Civile
		☐ Qendra e Zhvillimit	☐ Administrimi dhe Inspektoriati i Pyjeve
			☐ Skodrinon sh.a

Afati: Normal (7 ditë) | Prioritet (3 ditë) | Urgjent (brenda ditës) | Pa afat/për dijeni | Tjetër ___ ditë

Data 3.11.2025, Nr.Prot. 22463
Shënime të Kryetarit:

Nënshkrimi: Benet Beci

Marrë në dorëzim: 01.11.2025

Nënshkrimi



VENDIME, UDHEZIME, SHKRESA, KERKES
NR 22463 DATE 3.11.2025
DERGUAR NGA:

LËNDA:

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

FOROSIA E TITULLARIT

Tiranë më	30/10/2025
Nr.	6842

Lënda: Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër

Rruga "13 Dhjetori", Nr. 1, Shkodër

Partisë Socialdemokrate

Rruga "Skënderbej", Blloku i Ambasadave, Tiranë

Z. Sead Sabah Jusha

Lagja "Partizani", Shkodër


Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancën publike të datës 29.10.2025, mori në shqyrtim projekt-vendimin "Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Shkodër, pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidatit, vendosi "Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Shkodër, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialdemokrate" z. Sead Sabah Jusha.

Bashkëlidhur do të gjeni vendimin nr.1459, datë 29.10.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Sekretar i Përgjithshëm

(Në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29.10.2025

Nr: 1459

Ora: 12:00

6868 p-ol
30.10.20

VENDIM
PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SHKODËR, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E "PARTISË
SOCIALDEMOKRATE", Z. SEAD SABAH JUSHA

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 19303 prot., datë 29.09.2025, Këshilli i Bashkisë Shkodër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Erkan Qemal Hoxha, propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialdemokrate".

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate", për Këshillin e Bashkisë Shkodër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 13, z. Sead Sabah Jusha.

Me shkresën nr. 6276, prot., datë 03.10.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Shkodër, z. Sead Sabah Jusha, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit "Partia Socialdemokrate", ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-PSD-4290_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin,

Data: 29.10.2025 Nr: 1459
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër me kandidatin nga lista shumemërore e "Partisë Socialdemokrate", z. Sead Sabah Jusha"

verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Sead Sabah Jusha, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, me shkresën nr. 6362 prot., datë 08.10.2025, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 6360 prot., datë 08.10.2025, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për z. Sead Sabah Jusha.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 3259/1 prot., datë 17.10.2025, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Sead Sabah Jusha, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën nr. 16008/1 prot., datë 14.10.2025 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Sead Sabah Jusha, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Sead Sabah Jusha në këshillin e Bashkisë Shkodër, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:


Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

V E N D O S:


1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër, me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialdemokrate", z. Sead Sabah Jusha.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 29.10.2025 Nr: 1459
Ora: 12:00



"Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër me kandidatin nga lista shumëmemërore e "Partisë Socialdemokrate", z. Sead Sabah Jusha"